

Бр./Нр. 09 - 132/1
23.01 2026 год./viti

СКОПЈЕ - ШКУП



[Handwritten signature]

Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit
Ministry of Education and Science – Bureau for Development of Education

Byroja e Zhvillimit të Arsimit në kuadër të kompetencave dhe aktivitetëve të planifikuara në Programin për mbrojtjen e konsumatorëve për vitin 2026, i hartuar në pajtim me nenin 170 dhe nenin 171 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 236/22, 3/25 dhe 49/25) me rastin e 15 Marsit, Ditës Botërore të së Drejtave të Konsumatorëve dhe nën moton për vitin 2026 "Prodhime të sigurma, konsumatorë të sigurtë", shpall

KONKURS PËR ART FIGURATIV për fëmijët e kopshteve dhe për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme

Qëllimi i konkursit të artit figurativ është që fëmijët dhe nxënësit, në mënyrë krijuese, të shprehin të menduarit e tyre kritik lidhur me faktin se kur produktet janë vërtet të sigurma dhe të besueshme, njerëzit ndihen të sigurt gjatë blerjes dhe përdorimit të tyre, gjë që çon në rritjen e besimit dhe besnikërisë. Ndërkohë, produktet e pasigurma shkaktojnë lëndime, frikë dhe dëm ekonomik. Prandaj, është e nevojshme të theksohet nevoja për rregullore të forta, transparencë dhe praktikë etike për ndërtimin e besimit të konsumatorëve. Kjo nënkupton ndarjen e hapur të informacionit (përbërës të shënuar qartë, origjinë, afat përdorimi etj.), dëshmimin e pretendimeve për siguri përmes certifikatave (standarde të sigurisë së produktit, shenja për moshën e përdoruesit që mund ta përdorë produktin ose shërbimin etj.), udhëzime për përdorim të sigurt dhe komunikim të qartë për nxitjen e besimit të konsumatorëve.

Konkursi i artit figurativ organizohet në 4 (katër) kategori:

1. **Tema: LODRA TË SIGURTA – UNË JAM FËMIJË I LUMTUR**
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë fëmijët, përdorues të shërbimeve të institucioneve publike të kopshteve, të moshës 4–6 vjeç.
2. **Tema: KLASA IME – MJEDIS I SIGURT PËR TË MËSUAR**
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë nxënësit e arsimit fillor (mësim klasor) – nga klasa I (e parë) deri në V (e pestë).
3. **Tema: INFORMOHEM – KURSEJ**
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë nxënësit e arsimit fillor (mësim lëndor) – nga klasa VI (e gjashtë) deri në klasën IX (e nëntë).
4. **Tema: A ËSHTË VËRTET "E GJELBËR"? –LARJE E GJELBËR (GREENWASHING)**
Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë nxënësit e arsimit të mesëm – nga viti I (i parë) deri në vitin IV (e katërt).

MËNYRA DHE AFATI I PARAQITJES:

- Vepra figurative duhet të jetë punë e pavarur e nxënësit.
- Një nxënës mund të dërgojë **vetëm një** vepër figurative individuale.
- Krijimi figurativ duhet të bëhet në format dydimensionale dhe në teknika artistike dhe kombinime të tyre të përshtatshme për moshën e fëmijëve/nxënësve (**teknika e fllomasterit nuk do të merret parasysh**).
- Krijimi duhet të nënshkruhet vetëm në anën e pasme.
- Çdo krijim figurativ duhet të skanohet në një nga formatet: JPG, TIFF (**formatet PDF dhe fotografitë e punimeve nuk do të merren parasysh**).
- Fajlli me formën artistike duhet të numërohet.
- Të dhënat për krijimet figurative duhet të vendosen në tabelë (për shkarkimin e të dhënave të sakta të plotësuara dhe të dërguara në vord dokument në mënyrë elektronike – emri i autorit/fëmijës/nxënësit; mosha/klasa/viti; titulli i veprës; teknika e përdorur; emri i edukatorit/mësimdhënësit mentor; kontakti i edukatorit/mësimdhënësit mentor).
- Dosjet me krijimet figurative duhet të vendosen në një dosje me emrin e institucionit që dërgon.
- Dosjen e zipuar paraprakisht, përmes postës elektronike (për shkak të madhësisë së përmbajtjes përmes WETRANSFER, SENDSPACE, etj.), Institucioni Juaj duhet ta dërgoj me email në adresën elektronike info@bro.gov.mk, me shënimin: **Për konkursin e artit figurativ**.
- Numri maksimal i krijimeve të artit figurativ është **3 (tre)** nga çdo institucion.
- Afati për dorëzimin e krijimeve të artit figurativ është më së voni deri më **20 shkurt (e premte)**.
- Veprat e artit figurativ që nuk plotësojnë dhe ndjekin propozimet e mësipërme, si dhe ato të paraqitura pas afatit të caktuar, nuk do të merren parasysh.

Pjesëmarrësit e shpërblyer të konkursit të artit (**vendi i parë, i dytë dhe i tretë**) nga çdo kategori do të shpallen veçmas në faqen e Byrosë së Zhvillimit të Arsimit më **13 mars 2026**.

Për pyetje në lidhje me konkursin kontaktoni personin mr. Valentina Gocevska, në email adresën valentinagocevska@bro.gov.mk.

Ju mirëpresim!

Byroja e Zhvillimit të Arsimit